



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7, datë 27.06.2024

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10²⁰)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1.Simo Petromilo | 19.Grigor Dede |
| 2.Sokol Kushta | 20.Atird Hoxha |
| 3.Endri Hyseni | 21.Anxhela Shenaj |
| 4.Rajmonda Zoto | 22.Klodian Xhyheri |
| 5.Frosina Qyrdeti | 23.Besmir Brahimi |
| 6.Brikena Sika | 24.Elpiniqi Mërkuri |
| 7.Myzafer Elezi | 25.Elca Bezhani |
| 8.Illir Aliaj | 26.Bujar Osmanaj |
| 9.Roland Strakosha | 27.Anisa Ceno |
| 10.Novrus Rrokaj | 28.Geron Gunbardhi |
| 11.Jerina Dervishaj | 29.Shkëlqim Leskaj |
| 12.Lorel Canaj | 30.Liljana Breshani |
| 13.Gjergji Nika | 31.Ledja Shollaj |
| 14.Eglantina Aliaj | 32.Brikena Puka |
| 15.Ardian Musta | 33.Dikens Bushaj |
| 16.Arsen Belaj | 34.Refie Laze |
| 17.Evis Allushi | 35.Aurora Qarri |
| 18.Erëmal Arapi | 36.Marsela Dashi |

Mungojnë :

- 1.Vullnet Bilbilaj

- 2.Ervis Moçka
- 3.Simbol Pazaj
- 4.Briseida Çakërri
- 5.Edlira Kapllanaj
- 6.Vjola Xhafaj
- 7.Gëzim Çapoj
- 8.Edison Kapaj
- 9.Alta Haluci
- 10.Eneida Vera
- 11.Liri Dëma
- 12.Arjan Isufi
- 13.Mujo Shakaj
- 14.Eda Begaj
- 15.Englantina Imeraj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 7/1, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e këshillit të bashkisë. Janë dy përfaqësues të komunitetit Çam që duan të përshëndesin ditën e kujtimit të viktimave nga genocidi çam.

Z.Besmir Brahimi – Sot është 80vjetori nga masakra e grekëve, kundër viktimave të Çamërisë.Të mbahet 1 minutë heshtje në kujtim të këtyre viktimave.

(Mbahet 1 minutë heshtje) I paharruar kujtimi i tyre.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lexon shprehjen e ligjshmërisë , ardhur nga institucioni i Prefektit të Qarkut , për VKB Nr 43-48, datë 29.05.2024, ku të gjithë këto vendime, janë shprehur të ligjshëm nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë. Viojmë mbledhjen.

Z.Gjergji Nika – Në mbledhjen e Kolegjit të Kryetarëve, është lënë dakortësia me Kryetarin e bashkisë , për zhvillimin e mbledhjes në datën 27 qershor, ndërkohë që as Kryetari dhe as NënKryetarët, nuk janë prezentë.

Prandaj, Ju lutem lajmëroni të vijnë NënKryetarët.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Dakortësia është lënë për rendin e ditës, drejtorët janë të pranishëm.

Znj.Anxhela Shenaj – Kjo nuk është tek pika , “Të ndryshme”. Do të shikonim, shkëmbenim eksperiencë ..

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në miratimin e Procesverbalit të mbledhjes , datë 29.05.2024 Votohet.

Pro – 23 vota

Kundër – 1 votë, zoti Gjergji Nika

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.

Z.Daut Zëraj – Për procedurë është miratimi i procesverbalit.

Z.Gjergji Nika – Herën e kaluar opozita u largua nga mbledhja, çfarë të votojmë.

Z.Atird Hoxha – Unë e kërkoj fjalën për procedurë. Duhet ta dëgjojmë kolegen. Zonja Shenaj ,po diskuton për diçka që ka ndodhur. Pra, nuk duhet bërë...E para, duhet të dëgjojmë njëri tjetrin.... Zotëria, përfaqëson atë komunitet, komunitetin Çam, nuk do të thotë që, të kemi dualizëm...Kështu, mund ta thoshte kushdo, s’ka problem kush parti e thotë. Si datë do respektuar nga të gjithë...Të zbatohet rregullorja.

Z.Gjergji Nika – Neni 71, i Rregullores së Këshillit të Bashkisë...lexon Kryetarët e grupeve ndërhyjnë.....kijeni parasysh zonja Kryetare, pasi ne si kryetarë të grupeve, kemi pritur shumë për të thënë diçka.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Tek rendi i ditës, zoti Dorian i Drejtorisë Juridike, ka sjellë një projektvendim.(Lexon)

Z.Gjergji Nika – Nuk është mirë që të vijnë materiale në mbledhje, në momentin e fundit, kështu që, ajo që s’ka kaluar në mbledhjen e Kolegjit të kryetarëve, nuk do futet në rendin e ditës.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Zoti drejtor, çfarë ka me urgjencë ky projektvendim ?

Z.Dorian Demiri – Meqenëse mbledhja zhvillohet në fund të muajit, s’ka kohë.

Z.Gjergji Nika – Të mblidhet Konferenca e Kryetarëve të Grupeve.

Përpara se të fillojmë me rendin e ditës , lamë disa pika herën e kaluar. Ti kalojmë në fillim ato.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ti kalojmë më parë këto projektvendime dhe në fund pikën “Të ndryshme “

Z.Endri Hyseni – S’kemi pse bllokojmë punën , le ta dëgjojmë drejtorin juridik.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Miratojmë rendin e ditës, me projektvendimin që ka ardhur ?

Z.Grigor Dede – Nuk është hera e parë që vjen projektvendimi në momentin e fundit. I tërheq vëmendje administratës. Por, mbase është urgjente...e votojmë për të kaluar në rendin e ditës.

Z.Dorian Demiri – Është çështje funksionaliteti. Jemi në sezonin turistik. Mbledhja e këshillit, është në fund të muajit, kjo na kushtëzon.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë...Çdo projektvendim vjen dhe vendoset në Kryesinë e Këshillit të Bashkisë, pra duhet të mblidhet. Drejtori thotë, që na kushtëzon vetëm mbledhja në fund të muajit. Por, meqenëse, ky subjekt është i vetmi dhe ka kohë që pret, le të mblidhen dhe këkresat e tjera dhe, në 3 korrik ti kalojmë të gjitha ...Zonja Kryetare, le të vazhdojmë me rendin e ditës.

Z.Dorian Demiri – Ne jemi pjesë e administratës. Këshilltarët , nuk kanë pse të na etiketojnë në këtë lloj forme. Janë 2 kërkesa, 1 plotëson dokumentacionin, kjo është procedura.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Meqenëse, është një kërkesë, le ta fusim...votojmë rendin e ditës.

Z.Klodian Xhyheri - Nëqoftëse, e sjell pozita projektvendimin në momentin e fundit, e fusim në rend dite, nëqoftëse vjen nga opozita, nuk e fusim, pasi se kemi lexuar. Pra, nuk përdoret i njëjti standart.

Z.Gjergji Nika - Më gjeni një letër që vjen në bashki në datën 18.06 dhe vjen në datën 27.06 në mbledhjen e këshillit (lexon kërkesën)

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nuk e fusim në rendin e ditës.

Vijojmë, miratojmë këtë rend dite që na ka ardhur .

Votohet.

Pro – 34 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota .
Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 7/2, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Vazhdojmë rendin e ditës. Pika 1 , projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin maj 2024”. Relaton zonja Stasa.

Znj.Irena Stasa – Drejtorja e Ndhmës dhe Shërbimit Social,paraqet materialin për muajin maj,për përfitimin e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, ku përfitojnë 34 familje, me kushte shumë të vështira ekonomike, në të gjithë Bashkinë Vlorë.

-Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike, është 1 familje. Janë vetëm ndryshimet..

Znj.Elpinqi Mërkuri – E votojmë pikën 1 ?

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 7/3, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin maj 2024”.

E kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim- 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/4, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia si, dhe humbja e jetës së z.Thoma Loli, në banesën e z.Jurgen Loli dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Z.Atird Hoxha - Është për të ardhur keq, të rishikohen këto vlera qoftë në buxhet ... janë mjaft të ulëta..me këto vlera qesharake, për të ndihmuar ...Të gjendet një mekanizëm nga drejtoritë që, këto vlera mos të jenë kaq qesharake, pasi këtu ka dhe humbje të jetës.

Z.Adrian Vreshtazi – Është e drejtë, por llogaritja bëhet bazuar në disa dokumenta. Pra, nga procesverbali i konstatimit, shkon në Këshillin e Qarkut..., dëmet e banesave nga EKB.

VKM 329, e ka deri në 50%.. orenditë shtëpiake 50%.... Humbje jete 500 mijë lekë, brenda kornizave ligjore.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/5, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z.Ëngjell Kolila dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë”.

Votohet.

Pro 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/6, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për një ndryshim në VKB Nr 100, datë 29.12.2023, “Për buxhetin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024”, i ndryshuar.

Z.Gjergji Nika –Në Komisionin e Financës, kemi kaluar kalimin e fondit për Merkatën e Peshkut . Sot na ka ardhur një projektvendim i ndryshuar me zëra të tjerë. Ne kemi votuar në komision vetëm për merkatën e peshkut , vlera 4milion....Kanë sjellë tjetër projektvendim. Kam dy projektvendime në tavolinë.

Znj.Elca Bezhani – Të sqaroj lidhur me projektvendimin e ndryshuar. Në fakt në komision nuk kishte ardhur. Por drejtori i urbanistikës ka marrë një vendim për banorët e pallatit 1300. Kam diskutuar me kolegët e komisionit, të cilët nuk kanë qenë dakort ,por kam diskutuar dhe me drejtorin e urbanistikës dhe administratën. Drejtori i Urbanistikës ka ngulur këmbë, pasi është problemi, shumë emergjent, mund të ketë shembje pallati. Dhe në këtë moment....por s’jam dakort që projektvendimet të vijnë në momentin e fundit, por e konsideroj të rëndësishëm, pasi ka të bëjë me jetën e qytetarëve. Drejtori i financës do argumentojë.

Z.Gjergji Nika – Ky problem ka që kur është tenderuar ky pallat. Ka pas një investigim, i është hequr tenderi firmës...Pallati ka 1 vit e gjysëm që po bie, por jo në mënyrën si e kërkoni ju. Të gjitha i keni urgjent. Në komision kemi diskutuar për Merkatën e Peshkut.

Unë nuk jam me projektvendimin. Por,sot do kalojë projektvendimi për Merkatën e Peshkut, sillni vlerën e duhur.

Z.Atird Hoxha – Tek relacioni bashkëlidhur projektvendimit shtesë, për mua këtu kemi fallsitet. Përsa i përket projektvendimit, lexon relacioninthuhet, na ka ardhur projektvendimi për pallatin 1300, vlera 75 milion...

Falënderoj dhe median për raportimin.. ku zoti Kryetar, ka thënë që do bëhet, do zgjidhet ky problem..Ky është shtesë fondi.., të thërriten firmat për tender dhe mbase e bëjnë me këtë vlerë 75 milion. Ne s’kemi pse lëmë familjet..., po rikonstruksioni ...sepse, ky fond i pakësohet një komuniteti tjetër. Ky projektvendim ka fallsitet , ka penalitet në kushtet e një vepre penale. Zonja Kryetare, këtë ta kërkon Nëqoftëse rrezikohet jeta e banorëve, është përgjegjësi e bashkisë.

Z.Myzafer Elezi – Pak më parë refuzuat një projektvendim që është shtuar në momentin e fundit. Është patjetër një veper penale...ajo mund të ketë ndryshuar numër protokolli. Propozoj që,ne të hedhim për votim projektvendimin që u miratua në komision dhe kryesi ndërsa i dyti të vijë në mbledhjen tjetër, ose dhe jashtë radhe.

Z.Endri Hyseni – Nuk është e nevojshme të vijë me ndryshime, por me një kërkesë të këshilltarëve , të futet me ndryshime dhe e miratojmë.Dëgjoni argumentat dhe votojmë. Projektakti mund të votohet me ndryshime. E propozoj unë. Kam qenë në terren, është gjendja shumë alarmante e pallatit. E kanë fajin çmimet, kanë ndryshuar.

Z.Gjergji Nika – Ne nuk po diskutojmë që nuk japim fonde për pallatin, këtu është veper penale, është me dy numra protokolli. Drejtori i Financës, të flasë për Merkatën e Peshkut që kaluam në komision.

Z.Daut Zëraj – Ke dy projektvendime, ke dy variante. I pari që kaloi në komision dhe kryesi. Votoni kë të doni. Projektvendimi është paraqitur në dy variante.

Juve ju mungon dëshira të dëgjoni argumentin.

Z.Erëmal Arapi – Këto 35 milion, po ia jep kryetarit të organizatës së PS të Komunës Qendër. Ajo që u votua në mbledhjen e komisionit, jo me dy standarte.

Z.Grigor Dede – Përfaqësojmë qytetarët e Vlorës, mos ta harrojmë. Nuk është hera e parë që ndodh kështu kur ka emergjenca, të vijë një ndryshim në projektvendim.

Duhet ta kemi të qartë, që qytetarët e pallatit 1300 kanë kohë që presin zgjidhje dhe, ju po pengoni zgjidhjen e këtij halli. Është emergjencë. Jemi përfaqësues të tyre. Ka pas dy projektvendime. I hedhim në votim, votojeni me ndryshime. Ne do ti ndihmojmë qytetarët, juve jo.

Z.Gjergji Nika – Pallati ka 4 vjet. Të gjithë duam ti ndihmojmë qytetarët..Ai pallat ka 4 vite që është zvarrë. Heq një dhe vë një tjetër në protokoll. Vazhdoni punoni...

Znj.Elpiniki Mërkuri – Ia japim fjalën drejtorit , argumentimin e tij.

Z.Klaudio Mehmetaj – Për pallatin 1300, është ndërprerë kontrata me Firmën “Avduli “ për shkak të disa problematikave. Do bëhet tender tjetër. Nuk janë kryer punimet. Urgjenca është..., kanë filluar punimet.. Përsa i përket vlerës, Insituti i Ndërtimit dërgoi një shkresë ditën e hënë, vlera e re 108 milion lekë/vjetra. Diferenca nga vlera e parashikuar, 160 milion me vlerën 120 milion, i është shtuar pallatit 1300. Shkresa e protokolluar në datën 20, projektvendimi i ri me

numër tjetër protokollin, nuk është e njëjta shkresë me të njëjtin numër protokollin. S'ka gjë të jashtëligjshme.

Z.Gjergji Nika – As 3 milion s'të dalin prapë, I bëni mirë.

Z.Kozma Mali – Përsa i përket ndryshimit në projektvendimin e dytë, për vlerën financiare në lidhje me fondin shtesë 3 milion 321 mijë lekë/reja. Nuk do preket fondi i bashkisë, u prokurua me një vlerë tjetër rruga. Janë dy projektvendime me numër dhe data të ndryshme.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Drejtorët janë profesionistë, ti dëgjojmë. Janë dy projektvendime me numër dhe data të ndryshme. Nuk ka shkelje.

Z.Kozma Mali – Për Merkatën e Peshkut, ndryshon nga 603 në 602, ndërsa në projektvendim vlera “231” për investime.

Znj.Anxhela Shenaj – Ndryshimi i çmimeve në referencë...

Z.Geron Gunbardhi – Ne jemi pro, propozimit të drejtorëve..

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Kalojmë në votim, me ndryshime, projektvendimin e ardhur

Pro - ; kundër - ; abstenim- ;

Z.Myzafer Elezi – Nuk është vetëm numri i protokollit, por e bën përmbajtja. Jam kundër të hidhet në votim, ky akt në shkelje..E kam me formën, si hidhet në votim..

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – E hedhim në votim me ndryshime.

Votohet.

Pro – 24 vota

Kundër - 11 vota

Abstenim – 0 vota

E votojmë pa ndryshime .

Herën e parë me ndryshime projektvendimin, ishin 24 vota pro. S'miratohet, duhen 26 vota pro.

Tani po votohet pa ndryshime, me Merkatën e Peshkut..Mbledhjen e radhës do ta kalojmë, në fund të fundit, ca njerëz po ndihmojmë.

Z.Myzafer Elezi – Me ndryshime, projektvendimi u rrëzua, po të votohet siç ishte.

Z.Novrus Rrokaj – Ka keqkuptime. Nuk ndryshon asgjë..

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Marrim pak pushim me kryetarët e grupeve. Përsa ka të bëjë me jetë njerëzish dhe s'ka shkelje.

Z.Myzafer Elezi – U rrëzua forma, jo thelbi. Propozoj të miratohet varianti i parë.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – 5 minuta pushim, lini egon personale, ka të bëjë me jetë njerëzish.

Rifillon mbledhja në orën 11.45.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ky projekt do kalojë si ka ardhur në momentin e parë.

Z.Grigor Dede – Për shkak se, projektvendimi me ndryshime nuk morri kuorumin, ne bëmë gjithë përpjekjet e mundshme, opozita votoi kundër. Ky pallat do ngelet pa punime, opozita nuk mendon për qytetarët.

Z.Atird Hoxha – Në përgjigje të zotit Dede, nuk e di pse insiston, ne jemi këtu për qytetarët. Ky pallat ka 4 vjet që ka ngelur për shkak të tenderimeve që janë bërë... Unë e ftoj zotin Dede për mosfallsitete, mos të përmendë opozitë, kërkoj korrektësi.

Z.Gjergji Nika – Për drejtorin e urbanistikës, ka fajin “zero “. Shkresa ka ardhur shumë vonë tek drejtori i urbanistikës, ndërkohë që në bashki, ka dy javë që ka hyrë., ka probleme institucionale.

Z.Grigor Dede – Zoti Klaudio sqaroi shumë qartë për pezullimin e kontratës. Të gjithë këshilltarët socialistë votuan pro për këtë pallat. Opozita kundër, vazhdoni ta pengoni atë pallat, pa punime.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Ky projektvendim, me ndryshime, nuk pati numrin e votave. Ky projektvendim do hidhet në votim siç ka ardhur në fillim, vetëm për Merkatën e Peshkut. Votohet.

Pro – 31 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA ESHQIPËRISË

BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/7, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 6 e rendit të ditës, projektvendimi “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Etikës, Standarteve dhe Apelimeve, në Këshillin e Bashkisë Vlorë”.

Në lidhje me krijimin e këtij komisioni prej 7 anëtarësh, 4+3. Prpozimet nga kryetarët e grupeve.

Z.Atird Hoxha – Shumë mirë që të ngrihet ky komision. Një vërrejtje, pasi në Konferencën e Kryetarëve, ishin 3 anëtarë nga opozita.

Nga grupi ynë, propozoj zonjën Alta Haluci dhe zonjën Anxhela Shenaj.

Z.Gjergji Nika – Propozimin ia lë zotit Gunbardhi.

Z.Geron Gunbardhi – Propozoj zonjën Eda Begaj.

Z.Grigor Dede – Nga grupi i PS, propozoj zotin Roland Strakosha ; zotin Ilir Aliaj; zonjën Brikena Sika dhe zotin Simo Petromilo.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votojmë komisionin, me këto propozime.

Votohet.

Pro – 30 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.

Z.Grigor Dede – Propozoj për kryetar komisioni zotin Roland Strakosha.

Z.Atird Hoxha – Propozoj për zëvendëskryetar komisioni zonjën Alta Haluci.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Votojmë për kryetar z.Roland Strakosha dhe zv/kryetar, znj.Alta Haluci
Votohet.

Pro – 31 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet Komisioni i Etikës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 7/8, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për disa korrigjime dhe saktësime në VKB Nr 31, datë 02.04.2020 “Për miratimin e kodit të sjelljes dhe rregullave, për parandalimin e konfliktit të interesave të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë “.

Z.Daut Zëraj – Kemi bërë 3 plotësime, siç i kemi në relacion. Citon 3 ndryshimet, si ; Kjo rregullore i referohet këshillit bashkiak; vlera e dhuratave ..si dhe komisionet e përhershme me 7 anëtarë dhe Komisioni e Etikës , me 7 anëtarë, siç ka qenë në rregulloren e miratuar më parë .

Z.Simo Petromilo – Duke parë projektvendimin, pika “c” neni 7 , lexon...autoriteti që merret ...të formulohet : Autoriteti që merret me shqyrtimin dhe vlerësimin në raste ..,është Komisioni i Standarteve ...

Z.Daut Zëraj – Domethënë, me “thyerje” të bëhet me “shqyrtim “.

Z.Simo Petromilo - Komisioni merret direkt me sjelljen....

Znj.Elpinqi Mërkuri – E votojmë me propozimin e zotit Petromilo ?

Pro – 31 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/9, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 8 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e Rregullores së Komisionit Këshillimor “Për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si, dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë”.

Z.Daut Zëraj – Për shkak të procedurave në Komisionin Këshillimor...Aktualisht, ky komision është për vlerësimin e titujve, por s’ka patur një rregullore. Duke qenë se pjesa e emërtimit të rrugëve, shesheve etj.. menduam ta bëjmë pjesë të rregullores.

Kur u diskutua në Komisionin Juridik, dolën dhe propozime, disa propozime për ndryshime, i kanë sjellë me shkrim. Neni 9

Z.Roland Strakosha – U diskutua dhe në Komisionin e Mandateve dhe Rregullores dhe nga diskutimet , zoti Elezi pati disa shtesa ..Në Nenin 9 , paraqitje dokumentacioni ...pika 2, gërma “d”, të shtohet dhe një vërtetim nga Autoriteti i Dosjes , që nuk ka qenë punonjës i ish – sigurimit të shtetit.

Shtesë në Nenin 10,procedurat e shqyrtimit të propozimit..Të shtohet pika 6 në këtë nen...lexon.. në rastet kur personi nuk jeton... dhe propozuesi nuk ka plotësuar dokumentacionin sipas pikës “d”, këshilli bashkiak ti kërkojë një informacion Autoritetit të Dosjes, sipas pikës “a” dhe pikës “b” Ky ishte ndryshimi i dytë.

Në Nenin 12, kërkoi një shtesëparashikon refuzimin e propozuesit, të shtojë pikën “a” , që dokumentacioni, nuk është i plotë dhe pikën “b”, nuk përmbush kriteret e parashikuara .

Z.Myzafer Elezi – Duke qenë se ky komision është i rëndësishëm, kjo rregullore është shumë e rëndësishme. Rregullorja është akt administrativ që rregullon punën e komisionit. Propozimet e mia janë me shkrim, nuk di nëqoftëse keni ju diçka për të shtuar, po citoj ;

Mos të ketë qenë bashkëpunëtor i ish sigurimit të shtetit ..

Të shtohet, për rastet kur personi ka vdekur...., marrjen e këtij vërtetimi nga institucioni.

Tek Neni 10, të shtohet pika 6 (lexon propozimet e bëra, shkresën e dërguar me e-mail-Shkresa bashkëlidhur.)

Ju ftoj ta votojmë me këto ndryshime.

Z.Illir Aliaj – Tek pika 4 , do shtoja ...lexon ..nuk u jepen tituj agjenturave të huaja ..Të shtohet fjali ..nuk u jepen tituj që kanë qenë bashkëpunëtorë me fashizmin, me okupatorin.

Një pikë tjetër që duhet shtuar, nëqoftëse është marrë një titull nderi , mos të përsëritet .

Z.Klodian Xhyheri – Jam dakort me shtesat dhe propozimet e bëra, do sygjeroja bazuar në Ligjin 112/2013, “Për Dekoratat ...”ku emërtimin për dhënien e dekoratave , ka komision, kurse ne kemi emërtim “komitet “, Neni 48 Rregullores së këshillit.

Propozoj, pasi bazuar në ligjin që po diskutojmë , jo “komitet “, por “komision “

Z.Daut Zëraj – I jemi referuar ligjit, jo rregullores.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Me propozimet e bëra me ndryshime , e kalojmë për votim ?

Votohet.

Pro – 30 vota

Kundër - 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/10, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 9 e rendit të ditës, projektvendimi “ Për emërtim rruge, në territorin e Bashkisë Vlorë”.

Z.Myzafer Elezi – Një grup këshilltarësh por edhe Shoqata “Labëria” kanë bërë propozim për vlerësimin e figurës së mjekut Shezai Llanaj. Është vlerësuar “Nderi i Komunës “. Kudo që të pyesësh për doktorin,ka qenë i palodhur, punonte me orar dhe pa orar. Ka kontribuar kudo, në qytet dhe në fshat. Kam bërë një relacion, kushtuar punës dhe jetës së tij.(Lexon)

Propozoj që një rrugë të emërtohet me emrin e Doktor Shyqyri Llanaj.

Ju ftoj ta votojmë.

Znj.Rajmonda Zoto – Më vjen mirë që vijnë për vlerësime dhe figura të mjeksisë . Doktorin është simboli i profesionalizmit , koleg, ka punuar pa u lodh dhe në moshën e pensionit. E kam njohur personalisht. Është vlerësim i merituar.

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket këtij projektvendimi dhe atij më pas, duhet një procesverbal i Komisionit të Vlerësimit të Titujve, duhet ti bashkëngjitet materialit. Këto projektvendime, duke qenë se, kemi ngritur dhe Komisionin e Vlerësimit të Titujve, duhet të ketë bashkëlidhur dhe procesverbalin dhe diskutimet që janë bërë në komision, dhe në lidhje me anëtarët e këshillit që kanë konflikt interesi, nuk duhet të marrin pjesë në votim.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 31 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

(1 nuk morri pjesë në votim, znj.Elpinqi Mërkuri)

Miratohet.



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA Vlorë
Këshilli i Bashkisë

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/11, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 10 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e sheshit “Detarët Shqiptarë” dhe, vendosjen e memorialit me simbolet e detarisë , në territorin e Bashkisë Vlorë “.

Z.Klodian Xhyheri – Ka shumë gabime drejtshkrimore në projektvendime..., projektvendim shkruhet pa vizë në mes... dhe, projektvendimi të miratohet me ndryshimet e propozuara .

Znj.Elca Bezhani – Ka shumë problematika në shkresat e administratës. Personat përgjegjës të jenë më të kujdesshëm në përpilimin dhe shkrimin e shkresave. Qëndron vërrejtja e zotit Xhyheri.

Znj.Liljana Breshani – Gjuha shqipe është pasuri kombëtare, duhet të shkruhet dhe të flitet me standarte.

Z.Gjergji Nika – Nuk ka pse..., Nga vlerësimi i DBNJ, 66% janë vlerësuar mirë.

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim ?

Z.Klaudio Mehmetaj – Pozicioni i vendosjes , tek rrethi i dytë, nëqoftëse, nisësh nga “kulaçi” Nuk është ...Është tek ballina urbane. Janë 2 spiranca., tek ai rreth.

Z.Atird Hoxha – Nuk është e konfiguruar saktë.

Z.Klaudio Mehmetaj- Nga emërtimi teknik, propozimi ynë, është rrethi numër 4, aty ku janë spirancat.

Z.Atird Hoxha – Është emërtuar sheshi.

Z.Klaudio Mehmetaj – Është një diametër, rreth 8m...Do vendoset dhe një bust

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 30 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal
Nr 7/12, datë 27.06.2024

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Pika 11 e rendit të ditës, projektvendimi “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe, vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast”.

Votohet.

Pro – 30 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2024

Procesverbal

Nr 7/13, datë 27.06.2024

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika “Të ndryshme “

Relacion nga zonja Elca në lidhje me informacionin për Sh.A.Ujësjetllës-in.

Znj.Elca Bezhani – Është nisur një shkresë me kërkesat nga Komisioni i Financës dhe nga anëtarët e këshillit të bashkisë, firmosur nga Kryetare e Këshillit të Bashkisë , drejtuar administratës dhe Kryetarit të Bashkisë.

Së pari, kemi kërkuar informacion;

-Për qiratë e tokës bujqësore.

-Performancën e administratës dhe strukturën e re.

-Masat e marra për Sh.A.Ujësjetllësin, si agjent tatimor.

-Kemi kërkuar interperancë nga kjo ndërmarrje, në lidhje me gjyqet .

-Vendimet e Këshillit Mbikqyrës.

-Vendimet e gjykatës, për kompensimin financiar , A ka një data base etj, si dhe , kërkesat nga anëtarët e këshillit të bashkisë në mbledhjen e këshillit, si dhe Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe zhvillimit të Turizmit. Lidhur me të gjitha këto, na kanë ardhur përgjigje të ndryshme nga administrata. Do të ishte mirë të na relatohet nga anëtarët e Bordit të Ndërmarrjes së Ujësjetllësit.

Z.Atird Hoxha – Për procedurë. Janë një grup banorësh të Lagjes “1Maji”, që do të prishet shtëpia , pa asnjë njoftim. Të marrim pushim , të marrim kontakt, po ju prishen shtëpitë, jo beach baret.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Meqenëse, jemi në mes të procedurës, vazhdojmë dhe më pas , japim informacion, i takojmë. S’kemi asnjë informacion. Edhe kjo temë për qytetarët është.

Z.Sokol Kuçaj – Në lidhje me çështjet gjyqësore, që në vitin 2021, janë disa punonjës të Ndërmarrjes së Ujësjetllës – Kanalizime. Pjesa e padisë, për vjetërsi, sigurime shoqërore..Në relacion i kemi të pasqyruara dhe emrat e punonjësve. Këto janë akoma në fazë gjykimi. Deri tani s’ka akoma vendim gjykate. Ajo që e ka rënduar situatën, janë disa gjyqtarë me qëndrime të

ndryshme. Të shohim Gjykatën e Apelit. Ndaj këtyre vendimeve, është ushtruar apelim. Disa punonjës janë tërhequr nga kjo padi, rreth 10-15 punonjës. Kjo është gjendja ..

Z.Atird Hoxha – Kjo çështje është shumë sensitive, zoti Kuçi dhe zoti administrator, të vijmë para, është seancë pyetje – përgjigje,.. Për ta nisur, pasi dëgjuam një relacion të shkurtër .

- Anashkalimi financiar i vlerës nga punonjësit që kanë përfituar ?

-Sa është vlera e disbursuar e punonjësve nga kjo drejtori ?

-Nuk kemi asgjë kundër punonjësve apo me gjyqtarët...Nga një kalkulim i shkurtër nga, Sh.A.Ujësllës, janë sidursuar 430 milion lekë;

-86 milion lekë /reja në pritje

-Disa paqartësi , ky relacion nuk është kundërfirmosur nga Administratori i Sh.A.Ujësllës, por nga Drejtoria Tregëtare...Nuk nisët as nga Drejtoria Juridike.

Në këto kontrata kolektive, prevalon kontrata,...neni 159 i kodit të punës...lexon.. Kontrata kolektive, Neni 167 .. lexon ..punëdhënësiPra, nuk ka sesi ndërmarrja, pasi 51% ju dha AKUMI-t, njohje me kontratën.....Dega Juridike, ka pikëpyetje ?

Ky dëm financiar 1,2 milion euro, është një shifër e konsiderueshme, për arkën e Ndërmarrjes së Sh.A.Ujësllës. Vazhdon që ti ketë 1,9 milion euro borxh bashkisë, kjo ndërmarrje. E kemi ngritur këtë shqetësim.

Vlora sot vuan për ujë. Uji nuk ka parametrat minimalë. Pse nuk e ka kundërfirmos Drejtori i Ujësllës, se në rrugën elektronike thotë, Drejtoria Tregëtare. Pra, për shifrat 1,2 dhe 1,9 milion, mendoj se, kjo ndërmarrje ka falimentuar.

Në relacion janë paraqitur disa nga kontratat e firmosura nga punonjësit ndër vite

-Kush mban përgjegjësi për këto lekë të qytetarëve ?

-Kujt i është kundërdrejtuar me dëm ekonomik ?

-Atë që funksionon si agjent tatimor, ne si bashki, nuk e përfitojmë .

Ne ta kthejmë në seancë pyetje – përgjigje, për këtë grupë financiare, që i kalon 3milion euro.

Z.Klodian Xhyheri – Situata në Ndërmarrjen e Ujësllës, është pak a shumë...Ne kërkua si opozitë një komision të përkohshëm..Rreth 160 punonjës , i janë drejtuar Gjykatës . Nga ky moment , ka filluar ministria kërcënon për në SPAK. Kushdo që mendon se, i është mohuar e drejta , do ti drejtohet gjykatës. Lëreni gjykatën të bëjë punën . Është e papranueshme të detyroni punonjësit të heqin dorë nga gjykata. Kemi sasi të pakta të ujit dhe jo me cilësi . Ne duhet të fusim në rend dite situatën e ujit, për Ndërmarrjen e Ujësllës. Ne jemi për qytetarët, nuk furnizohen me ujë, ka blloqe të tëra.

Z.Atird Hoxha – Ky relacion që kemi përpara, ka ardhur me numër protokoll..ky pra, ka ardhur fizikisht , në rrugë zyrtare.

Z.Daut Zëraj – Në këshill ka ardhur me e-mail, informacioni.

Z.Gjergji Nika – Nuk ka as protokoll, as firmë.

Z.Erëmal Arapi –E-maili është dokument zyrtar, por pa firmë e pa vulë.

Znj.Elca Bezhani – Është një relacion në lidhje me pikëpyetjet e drejtuara nga ne.

Z.Illir Aliaj – Ai është një relacion, nuk është si relacionet e projektvendimeve.

Z.Atird Hoxha – Pse justifikon një shkresë pa firmë. Zonja Kryetare e komisionit bëri një relacion, dhe janë paraqitur shkresat e firmë e me vulë. Nuk përmban elementët formalë. Ky është debat prej 3-4 muajsh , e më shumë. Ne prisnim një relacion me firmë e me vulë. Kush mban përgjegjësi për këto shifra, kur është pa firmë e pa vulë. Si do diskutojmë.

Z.Novrus Rrokaj – Administratori është prezent, mos të bëjmë lojra fjalësh.

Z.Geron Gunbardhi – Ky informacion nuk është real. Pa firmë, pa vulë . Firmose dhe sille.

Z.Illir Aliaj – Nuk është dokument zyrtar, është thjesht një relacion. Herën e kaluar , kam bërë kërkesë për të kaluar uji për vaditje , në komunën Shushicë. Nuk pres sot dokument me firmë e vulë. Nëqoftëse, ju e doni një informacion shterues, me firmë e me vulë, le ta sjellin në mbledhjen tjetër.

Z.Gjergji Nika - Ky nuk është një dokument zyrtar. Kemi 3 profesionistë, ish drejtues të ndërmarrjes. Më thoni, a është një dokument zyrtar , ky ?

Mendoj ta shtyjme dhe të na vijë dokument zyrtar, i firmosur dhe vulosur .

Znj.Elpiniki Mërkuri - Le të firmoset dhe të vuloset dhe le të na vijë në mbledhjen tjetër.

Z.Grigor Dede – Këto janë shqetësime të të gjithëve, ne. Janë prezentë 2 përfaqësues të Bordit dhe Administratori. Ka ardhur relacioni.U ngrit ky shqetësim dhe , le të firmoset dhe të vuloset , të protokollohet dhe të vijë mbledhjen tjetër. Po e anashkaloni shqetësimin, po merreni me shkresën. Është dhe drejtuesi i institucionit, të vijë materiali i firmosur dhe protokolluar në mbledhjen tjetër.

Znj.Elca Bezhani – Kam komente për relacionin nga administrata.

-Kontratat nga Këshilli Mbikqyrës, për përcaktimin e pagës së punonjësve që nga viti 2008. Nga viti 2008 – 2022, Dega Juridike ka 3 kontrata kolektive..lexon që në pagë të jetë e përfshirë 2% i vjetërsisë..

Kjo për mendimin tim, Këshilli Mbikqyrës , 2% është i përfshirë në pagë, dhe jo të kërkohej sipas kontratës së tyre...

Kontrata e vitit 2018 ...ka një mospërputhje midis Këshillit Mbikqyrës dhe Kontratave kolektive. Në vitin 2022, është miratuar një nivel page..

Z.Atird Hoxha – Është me dy standarte. Ta vendosë gjykata. Po flasim për dëmin financiar.

Znj.Elca Bezhani – Llogaritja... Kam një pyetje , për pjesën juridike , s'jam kompetente, por , në Vendimet e Gjykatës së Përkohshme,

-A janë apeluar ...Çfarë qëndrimi ka mbajtur ndërmarrja , që disa punonjës i marrin pagesat rufe, ndërkohë që, vendimi është i përkohshëm ?

Z.Sokol Kuçi – Cilat janë pyetjet ?

Znj.Elca Bezhani – Duhet të jemi më parë qytetarë të denjë.

Znj.Elpiniki Mërkuri – Mendoj që, kjo mbledhje po tejzgajtet . Ju lutem, kjo formë e ngritjes së zërit , nuk zgjidh asnjë çështje. Ta përmbledhim pak..

Z.Grigor Dede – Zoti Sokol , lexoi relacionin, sqaroi për pjesën e gjykatës. Zoti Xhyheri foli për furnizimin e ujit. Është një investim madhor që do të bëhet, mbi 20 milion euro. Në mbledhjen tjetër , relacioni, do të vijë me firmë dhe i protokolluar. S'po merremi vesh.

Z.Atird Hoxha – 3 milion , të qytetarëve, ku janë ?

Z.Grigor Dede – Nuk është fare normale ngritja e zërit, emrat që përmendni.. Flisni për shqetësimin.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kjo u kthye në politike.

Z.Gjergji Nika – Për proçedurë, neni i rregullores...Zoti Hoxha, zoti Xhyheri, zonja Balla , bënë pyetje. Janë këtu 3 përfaqësues, të na kthejnë përgjigje.Ata thonë, cilat janë pyetjet ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – Të lutem. Zotërinjtë janë të lirë të kthejnë përgjigje, për disa të tjera dhe le ti kthejnë me shkrim. Por, s'mund të jetë i përgatitur për të gjitha pyetjet. Do ti kthejë dhe me shkrim.

Z.Gjergji Nika – Unë shikoj në këtë raport që, Ndërmarrja e Ujësjellësit ia ka deleguar fajin Këshillit Mbikqyrës...lexon..Në faqen 8, të relacionit....Pra, Komisioni i Përkohshëm që unë diskutova, është në sintoni dhe me Ndërmarrjen e Ujësjellësit që, i ka thënë Këshillit Mbikqyrës.

A i dinë detyrat, anëtarët e Këshillit Mbikqyrës ?

Manuali është 62 faqe, dhe në një faqe janë detyrat e anëtarit të Këshillit Mbikqyrës ...lexon,,Janë përgjegjës ...

Unë duke parë neglizhencën e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, i drejtohem Kryetarit të Bashkisë, për heqjen e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe zëvendësimin e tyre.

Z.Sokol Kanani – Drejtorja i relatton Këshillit Mbikqyrës, përgjigje për shkresën pa firmë..Jemi shoqëri aksionere..

Ndaheni mendjen, është dëm financiar apo një e drejtë e mohuar për punonjësit ?

Z.Erëmal Arapi – Lexon..Në një paragraf ...që Drejtorja Tregtare...të merren masa me një jurist , kur ka konflikt interesi

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lidhur me Ujësjellësin, a ka pyetje tjetër ?

Z.Geron Gunbardhi – Gjithë këtë dëm në këtë ndërmarrje;

-3,2 milion euro dëm, të kthejnë përgjigje.

-Na vini në dispozicion për 2 investimet e pambaruara.

Këta punonjës që kanë të drejtë, sikur, drejtuesit ti thërrisnin , ligji e ka përcaktuar, bëhet një akt marrëveshje.

-Nëqoftëse, do thirrej çdo punonjës, do ti njihej e drejtë e mohuar, sa do të ishte borxhi ?

-Vendimet e Gjykatës janë të shkruara..Neni 2, pika 2 lexon...

Çu bënë 3,2 milion euro ?

Z.Illir Aliaj – Nëqoftëse, do vazhdojmë kështu, mendoj që, kjo mbledhje zonja Kryetare, duhet mbyllur.

Relacioni s'ju pëlqen , se është pa firmë. Nuk mund të bëjmë dot një analizë , opozitës që si pëlqen, si në formë dhe, ndërkohë bëhen shumë pyetje mbi këtë relacion.

Mendoj që ta shtyjme këtë relacion për mbledhjen tjetër. Le të bëhen dhe kërkesat dhe pyetjet e tjera dhe ta kemi mbledhjen tjetër .

Z.Arsen Belaj – Vërtet është problem shqetësues për ne Ujësjellësi. Shqetësimi im dhe shqetësimi i zotit Çapoj, në lidhje me turizmin në Orikum. Problem shumë infrastruktura, ujësjellësi, dritat, problem ndriçimi.

Rrugët copë – copë. Nuk e kuptoj çfarë turizmi do bëjmë. Në Orikum, nuk është bërë asnjë investim.

-Shqetësim tjetër, zënia e hapsirave publike. Vitin e kaluar taksa 2000lekë/m², sivjet 4000lekë/m², të ndara sipas zonave.

Kush quhet hapsirë publike e mbyllur dhe, kush quhet e hapur ?

Është shqetësim, pasi po shpërndahen faturat e zënies së hapsirave publike.

Ta rishikojmë këtë Vendim të Këshillit të Bashkisë. Është 2000 lekë. Duhet dhënë zgjidhje.

-Mbeturinat , shumë problem. Nuk duhet të gjykojmë politikisht gjithmonë.

Z.Grigor Dede – Shqetësime dhe problematika që na shqetësojnë ka ...Një motivim për ata që punojnë dhe gjatë natës, për punonjësit e pastrimit, gjelbërimit, policisë bashkiake, zjarrfikësen . Mirënjohje dhe falenderim për ata.

Z.Klodian Xhyheri – Shqetësim për vendosjen me detyrim për impjantin e ujrave të zeza.

Kushtojnë shumë. Këto impjante që vendosen, subvencionohen. Këto tani në sezonin turistik dhe, me detyrim.

Z.Novrus Rrokaj – Nuk është punë e bashkisë, është e ministrisë .

Z.Klodian Xhyheri – Duhet të ngremë zërin, po falimenton biznesi.

Znj.Frosina Qyrdeti – Nuk ka lidhje me këshillin. Ke ndonjë gjë për qytetin.

Z.Gjergji Nika – Kemi dy relacione, një nga Qendra e Trajtimit të Studentëve dhe Tregun me Shumicë, fruta perime .Duhet të shqetësohemi, pasi drejtoritë në varësi të bashkisë, janë me humbje. Përshtypje më bën relacioni i Qendrës së Trajtimit të Studentëve.. ka 850 mijë euro detyrime ,dhe detyrën e ka filluar me 610 mijë euro.

Më shqetëson që ... drejtoresha thotë që, dëshiron të shtojmë ..drejtoresha pranon që shoqëria është në kolaps. Nga drejtoria e financës , të na sjellë një analizë financiare si do dalë nga kolapsi. Është rritur humbja me 300 mijë euro.

Të na vijë një analizë financiare për të dalë nga ky kolaps.

Duhet ti lexojmë me kujdes relacionet, të gjithë këshilltarët.

Z.Sokol Kushta – Tek Rajoni 2 dhe Rajoni 3 , tek “3 Racat” janë 30 biznese. Më kanë ardhur shumë ankesa, paguajnë taksën gjithë vitin. Me vend dhe pa vend vihen kioska.

-Mungojë tualetet, mungon uji..Shumë problem, mungesa e tualeteve.

Të shihen të gjitha bizneset , të shikohen nga administrata.

Z.Atird Hoxha – E falënderoj zotin Kushta , e mbështes në lidhje me bizneset që vijnë nga vende të tjera. Pse mos të shihet ky problem, që këto ti marrin bizneset vlonjate. Ti shohë administrata.

Kam 2 shqetësime :

Në Rajonin Nr 3 , në një park, mbas “Kalit të Trojës”, tek vendparkimet, ekzistojnë dhe disa frigoriferë që bëjnë zhurmë të llahtarshme. Të shihet, a janë të licensuar ?

Për turizmin.

Sot qyeteti i Vlorës , ka një infrastrukturë shumë të dobët në akset kryesore, në sezonin turistik. Edhe zoti Belaj dhe zoti Çapoj, e kanë ngritur këtë shqetësim dhe na është thënë, që do na vijë një relacjon.

Kemi dhe një zonë epidemike, pranë një rrjedhje uji , tek një rreth rrotullim në hyrje, pasi hidhen mbetje inerte, zonë vizualisht e ndotur.

-Problemi i furnizimit me ujë të pijshëm në shumë zona.

Mendoj që, edhe për shqetësimet e banorëve që po presin, ti dëgjojmë. Jemi këtu për problemet e qytetrëve.

Z.Erëmal Arapi – Propozoj që, në mbledhjen e ardhëshme , në Bordin e Klubit të Futbollit “Flamurtari”, këtu është një anëtar i këshillit. Po kalon afati . Anëtar i këshillit që është në bord, të na japë një informacion.

Znj.Anxhela Shenaj – Në lidhje me kë u konsultuat , që bëtë vizitën , me kë nga kryetarët e grupeve ?

E para, Bashkia Sarandë , është më e vogël se Bashkia Vlorë, s’përbën sens të marrësh eksperiencë nga bashki e vogël, dhe ditën e shtunë dhe të dielë.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Ka ca njerëz që presin jashtë, mos vazhdo me këto lloj gjërash.

Të ftojme njerëzit që presin, qytetarët. Janë banorë të lagjes “1 Maji “

-Janë banorë që banesat e tyre preken nga projekti “Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar “

Mbas diskutimeve me qytetarët , këshilltarët, dhe Zëvendëskryetaren e Bashkisë Znj.Irena Toshkallari që ishte e pranishme, u la që, banorët do të paraqiteshin në bashki , në takim në drejtorinë e urbanistikës për të parë projektin.